



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:105583
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640515

Pml.nr.270/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit Xh. B., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av.Egzon Doli, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PPr.KR.nr.17/2024 të datës 4.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.320/2024 të datës 12.4.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29.4.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit Xh. B., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PPr.KR.nr.17/2024 të datës 4.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.DKR.nr.320/2024 të datës 12.4.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPr.KR.nr.17/2024 të datës 4.4.2024, të pandehurit Xh. B., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK, ia ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, e cila masë do t'i zgjasë nga data 3.4.2024 deri më datën 2.5.2024. Masa e paraburgimit i është caktuar në bazë të nenit 184 paragrafi 1. nën par. 1.1, dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNI.DKR.nr.320/2024 e datës 12.4.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Xh. B. av.Egzon Doli, për shkak të shkeljes së dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 të KPP të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit ose kjo masë të zëvendësohet me ndonjë masë tjetër më të butë masa e arrestit shtëpiak.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.118/2024 të datës 26.4.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se aktvendimet e kundërshtuara nuk janë përpiluar konform dispozitave ligjore të KPP, pasi që aktvendimet e kundërshtuara nuk përmbajnë arsytim dhe se arsyetimi i aktvendimeve nuk përmban vlerësim të fakteve të mbështetura me prova të artikulueshme, mbi bazën e të cilave të pandehurit i është caktuar paraburgimi. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk i janë përmbajtur detyrimeve sipas nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 të KPP, nuk kanë vërtetuar kushtet – bazat për caktimin e paraburgimit, kushtet janë vlerësuar në mënyrë abstrakte dhe vetëm janë parafrazuar dispozitat ligjore. Nuk kanë dhënë arsye as lidhur me ekzistimin e dyshimit të bazuar se i pandehuri a ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Mungesa e arsytimit të detajuar lidhur me të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe një proces gjyqësor të rregullt. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ potencon se arsyet themelore në bazë të të cilave mund të vendoset masa e paraburgimit, duhet të shqyrtohen dhe vendosen në frymën e detyrimeve të autoriteteve përgjegjëse që të kenë parasysh edhe masat tjera alternative për sigurimin e prezencës së të pandehurit e jo vetëm masën më të rëndë të paraburgimit. Prezenca e të pandehurit në afërsi të familjarëve të tij është tejet e domosdoshme për shkak të faktit se fëmija

i tij njëvjeçarë vuan nga sëmundja e meningjtit (meningitits acuta) si dhe nga anomalia DSD dhe se ai ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme dhe se për te aktualisht kujdeset është vetëm bashkëshortja e tij.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit R-2024-XI-DKKO-HTN-GJK-11 të datës 4.4.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, konfiskimi i qeseve me sasi si në shkresat e lëndë, me substancë narkotike që dyshohet të jetë kokainë dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se mund të ketë kryer veprën penale për të cilën dyshohet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, sepse procedura penale është në fazën fillestare të hetimeve dhe se me lënien në liri të të pandehurit ekziston mundësia që i njëjti të pengojë rrjedhën e procedurës penale duke u arratisur, ikur apo fshehur për t'iu shmangur përgjegjësisë penale e në këtë mënyrë do ta pamundësohet zhvillimi i rregullt i procedurës penale.

Kjo gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e masës së paraburgimit konform neni 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, përgatitja e qeseve të mbushura me sasi të substancave narkotike të dyshuar kokainë, peshorja, etj, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj caktimi i paraburgimit, për fazën në të cilën është procedura penale është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera alternative, sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit nuk janë masa adekuate për fazën në të cilën ndodhet procedura penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të neni 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr. 270/2024 me datën 29.04.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Mejreme Memaj